

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Elementet e njohurive të
Auditimit të Brendshëm
Internal Audit Knowledge
Elements**

B1

ID Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË
TË KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 28/09/2024

CONTENT/ PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i dhënë	Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK PIKËT E DHËNA
1. Pyetje (50 x 2 pikë)	100	
Gjithsej	100	

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

1. Përcaktimi nëse një drejtor ose zyrtar i korporatës ka përmbushur detyrën e tij / saj të kujdesit, matet:
 - a) Para se të merret një vendim
 - b) Në kohën kur merret një vendim**
 - c) Pasi të merret një vendim
 - d) Në kohën kur nuk merret një vendim
2. Qeverisja e korporatës ka një ndikim të fuqishëm në aftësinë e firmave që të :
 - a) Mbijetojnë vazhdimisht
 - b) Të ndihmoj në rritjen e firmës
 - c) Të krijoj avantazh konkurrues**
 - d) Të performoj më mirë
3. Çmimi i naftës së papërpunuar për fuçi sot është 105€ dhe ekziston një probabilitet prej 25% që çmimi të rritet në 115€ në vitin e ardhshëm, një mundësi 25% që çmimi do të bjerë në 100€, dhe një mundësi 50% për një rritje të lehtë në 110€. Cila nga sa vijon është çmimi i ardhshëm i një fuçi naftë të papërpunuar duke përdorur një qasje me vlerë të pritshme dhe duke rrumbullakuar përgjigjen?
 - a) 108€
 - b) 109€**
 - c) 113€
 - d) 115€

Metoda e vlerës së pritshme përfshin caktimin e vlerësimeve të probabilitetit ndaj rezultateve alternative dhe përmbledhjen e produktit të rezultateve të ndryshme. $115€ \times 0.25 + 100€ \times 0.25 + 110€ \times 0.50 = 28,75€ + 25€ + 55€ = 108,75€ \sim 109€$

4. Cilët nga faktorët strategjikë të mëposhtëm luajnë rol në përcaktimin e një çmimi bazë?
 - I. Objektivat e kompanisë
 - II. Strategjia e pozicionimit
 - III. Strategjitë e reja të çmimeve të produkteve
 - IV. Dallimet në cilësi dhe çmime
 - a) I dhe II
 - b) II dhe III
 - c) III dhe IV
 - d) I, II, III dhe IV**
5. Aksionet preferenciale dhe të zakonshme ndryshojnë në atë që:
 - a) Dështimi për të paguar dividendët në aksione të zakonshme nuk do ta detyrojë firmën në falimentim ndërsa mos pagimi i dividendëve në aksionet preferenciale do ta detyrojë firmën në falimentim

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

- b) Dividendët e aksioneve të zakonshme janë në shumë fikse ndërsa dividendët e aksioneve preferenciale nuk janë
- c) **Aksionet preferenciale kanë një përparësi më të lartë se aksionet e zakonshme në lidhje me fitimet dhe pasuritë në rast të falimentimit**
- d) Dividendët e aksioneve preferenciale janë të zbritshëm si shpenzim për qëllime tatimore ndërsa dividendët e aksioneve të zakonshme nuk janë

6. Informacioni i pjesshëm i bilancit për një kompani për vitet që përfundojnë më 31 Dhjetor 2017 dhe 2018 janë:

	31.12.2018	31.12.2017
Pasuritë rrjedhëse (përveç parasë)		
Llogaritë rrjedhëse	€20,000	€5,000
Stoqet	€50,000	€14,000
Shpenzimet e parapaguara	€3,000	€6,000
Detyrimet rrjedhëse		
Llogaritë e pagueshme	€32,000	€16,000
Tatimi i pagueshëm në pronë	€4,000	€3,000

Kapitali punues u rritë në vitin 2018 me €12,000. Ndryshimi i parave të gatshme në vitin 2018 ishte:

- a) €12,000
- b) €43,000
- c) **€ (19,000)**
- d) € (36,000)

Ndryshimi në para = Ndryshimi në kapitalin punues - Ndryshimi në pasuritë rrjedhëse jo-monetare + Ndryshimi në detyrimet rrjedhëse

Ndryshimi në para = 12,000 - (15,000 + 36,000 - 3,000) - (16,000 + 1,000) = - 19,000€

7. Një kompani kishte 500 njësi në stoqet fillestare që kushtonin 5 € për njësi. Më 1 mars, kompania bleu 300 njësi me një kosto prej 7€ secila. Më 1 shtator u blenë edhe 300 njësi të tjera. Gjatë vitit u shitën 700 njësi dhe saldo përfundimtare e stoqeve është €2,500. Nëse kompania përdor metodën (FIFO) të vlerësimit të stoqeve, atëherë kostoja për njësi e artikujve të blerë në 1 shtator, në centin më të afërt, ishte:

- a) 3.67€
- b) **6.00€**
- c) 6.67€
- d) 7.58€

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

$$2,500\text{€} = 100\text{njs.} \times (7\text{€}) + 300\text{njs.} \times (\text{kosto e panjohur})$$

$$\text{Kosto e panjohur} = (2,500\text{€} - 700\text{€}) / 300\text{njs.} = 6.00\text{€}$$

8. Një nga avantazhet kryesore të buxhetimit është se:
- Nuk zë vendin e menaxhimit dhe administrimit
 - Bazon planin e fitimit në vlerësime
 - Adaptohet vazhdimisht për t'iu përshtatur rrethanave që ndryshojnë
 - Kërkon nga menaxherët e departamenteve të bëjnë plane në përputhje me planet e departamenteve të tjera të ndërvarura**
9. Cila nga sa vijon NUK është një ndryshore në studimin ndërkombëtar të Hofstede për kultura të ndryshme?
- Distanca e fuqisë
 - Orientimi politik**
 - Individualizmi-kolektivizmit
 - Shmangia e pasigurisë
10. Cili nga opsionet e listuara si më poshtë NUK është një shembull i mbajtjes së rrezikut?
- Vetë-sigurimi.
 - Përdorimi i një klauzole të mohimit të garancionit në paketimin e produktit.**
 - Mbajtje e paplanifikuar.
 - Përdorimi i një fondi rezervë për të parapaguar dëmtimin fizik të makinave të kompanisë.
11. Cila nga opsionet e mëposhtme klasifikohet si rrezik strategjik i menaxhimit të rrezikut të ndërmarrjeve (ERM)?
- Rreziku i tregut
 - Fatkeqësitë natyrore
 - Rreziku i reputacionit**
 - Rreziqet që ndërlidhen me sistemet, proceset dhe teknologjinë.
12. Duke ekzaminuar sesi të ardhurat dhe kostot ndryshojnë për një seri çmimesh, një menaxher mund të përcaktojë:
- Çmimin e rentabilitetit
 - Çmimin marxhinal të fitimit.
 - Çmimin për maksimizimin e fitimit**
 - Çmimin elastik.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

13. Cila nga opsionet e mëposhtme është e dobishme për të marrë reagime prapa (feedback) nga punonjësit që largohen nga ndërmarrja?
- a) Sistemi i sugjerimeve.
 - b) Intervista dalëse**
 - c) Ofrimi i ndihmës për të gjetur punë te re
 - d) Opinioni për punësime të reja
14. Cilat janë dy dimensionet e Matricës së Boston Consulting Group?
- a) Përfitueshmëria dhe rrjedha e parave
 - b) Normat e rritjes dhe pjesa e tregut.**
 - c) Përfitueshmëria dhe ritmet e rritjes.
 - d) Normat e rritjes dhe fluksi i parave.
15. Kompania A bleu Kompaninë B për 1,000,000€. Në kohën e blerjes, neto pasuritë e Kompanisë B kishin një vlerë kontabël prej 900,000€ dhe një vlerë të drejtë tregu prej 800,000€. Shuma e zërit të mirë që Kompania A ka regjistruar në datën e blerjes ishte:
- a) 0€
 - b) 100,000€
 - c) 200,000€**
 - d) 300,000€

Zëri i mirë është i barabartë me tejkalimin e kostos së blerjes mbi vlerën e drejtë të tregut të pasurive të blera.
Zëri i mirë = $1,000,000 - 800,000 = 200,000$

16. Paraqitur më poshtë janë të dhënat e pasqyrave financiare të fundvitit të pjesshëm për kompanitë A dhe B.

Pasqyra e pozitës financiare	Kompania A	Kompania B
Paraja	100€	200€
Të arkëtueshmet	Nuk dihen	100€
Stoqet	Nuk dihen	100€
Pasuri fikse neto	200€	100€
Të pagueshmet	100€	50€
Borxhi afatgjatë	200€	50€
Aksionet	100€	200€
Fitimet e mbajtura	150€	100€

Pasqyra e të ardhurave	Kompania A	Kompania B
Shitjet	600€	5,800€
KMSH	300€	5,000€
Shp. administrative	100€	500€
Shp. e zhvlerësimit	100€	100€
Shp. e interesit	20€	10€

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

Shp. e tatimit në fitim	40€	95€
Fitimi Neto	40€	95€

Nëse Kompania A ka një Raport të shpejtë (Quick ratio) prej 2, atëherë ajo ka një bilanc të llogarive të arkëtueshme prej:

- a) **100€**
- b) 200€
- c) 300€
- d) 500€

$$\begin{aligned} \text{Raporti i shpejt} &= (\text{Paraja} + \text{Të arkëtueshmet}) / \text{Të pagueshmet} \\ 2 &= (100 + \text{Të arkëtueshmet}) / 100 \\ \text{Të arkëtueshmet} &= 2 \times 100 - 100 = 200 - 100 = 100 \end{aligned}$$

17. Nëse një kompani përdor politikën e dividendit të mbetur (residual), ajo do të paguajë:
- a) Një dividend fikse parash çdo tremujor dhe përdor mbetjen si fitim të mbajtur.
 - b) Një dividend të aksioneve fikse çdo tremujor dhe mban të gjitha fitimet si një mbetje.
 - c) Të gjitha fitimet si dividendë çdo vit.
 - d) **Dividentët vetëm nëse fitimet tejkalojnë shumën e nevojshme për të mbështetur një buxhet optimal të kapitalit.**

18. Më 1 janar, një kompani NUK ka bilanc fillestar/hyrës të inventarit. Gjatë vitit janë bërë blerjet e mëposhtme:

Data	Njësitë e blera	Kosto për njësi
1 Janar	5,000	10€
1 Prill	5,000	9€
1 Korrik	5,000	8€
1 Tetor	5,000	7,5€

Janë 10,000 njësi në inventar më 31 dhjetor.

Nëse kompania përdor (FIFO) të vlerësimit të inventarit, bilanci përfundimtar i inventarit do të jetë:

- a) **77,500€**
- b) 85,000€
- c) 86,250€
- d) 95,000€

Nëse vlerësimi i inventarit bëhet sipas metodës FIFO, 10,000 njësitë në inventarin përfundimtar supozohet se kanë qenë artikujt më të fundit të blerë. Kostoja e 10,000 njësive më të fundit të blera është:
 $5,000 \times 7.5€ + 5,000 \times 8€ = 37,500€ + 40,000€ = 77,500€$

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

19. Një kompani po përdor teknikat e buxhetimit të kapitalit për të krahasuar dy projekte të pavarura. Mund të pranohet njërin, të dy, ose asnjërin prej projekteve. Cila nga pohimet e mëposhtme është e vërtetë në lidhje me përdorimin e metodave të vlerës së tanishme neto (NPV) dhe të normës së brendshme të kthimit të rregullt (IRR) për vlerësimin e këtyre dy projekteve?

a) Kriteret e NPV dhe IRR gjithmonë do të çojnë në të njëjtin vendim pranimi ose refuzimi për dy projekte të pavarura.

b) Nëse IRR i projektit të parë është më i lartë se kostoja e kapitalit të kompanisë, projekti i parë do të pranohet por projekti i dytë jo.

c) Nëse kriteri i NPV çon në pranimin ose refuzimin e projektit të parë, nuk mund të parashikohet nëse kriteri IRR do të çojë në pranimin ose refuzimin e projektit të parë.

d) Nëse kriteri i NPV çon në pranimin e projektit të parë, kriteri IRR nuk do të çojë kurrë në pranimin e projektit të parë.

20. Një kompani po përpiqet të përcaktojë çmimin optimal të shitjes për një produkt të ri dhe e di që për të qenë konkurrues, produkti i ri duhet të shitet për 75€ ose më pak për njësi. Shpenzimet fikse vlerësohen në 150,000€ për nivelet e prodhimit deri në 4,000 njësi, dhe shpenzimet variable në 4,000 njësi parashikohen në 40,000€.

Me cilin çmim të shitjes secila njësi e shitur do të kontribuojë 50€ drejt shpenzimeve fikse?

a) 40€

b) 60€

c) 65€

d) 75€

Problemi kërkon që marzhi i kontributit për njësi të jetë 50€. Marzhi i kontributit për njësi është i barabartë me çmimin e shitjes për njësi minus shpenzimet variable për njësi, të cilat janë 10€ për njësi (40,000€ e ndarë me 4,000 njësi). Prandaj:

$$50€ = \text{Çmimi i shitjes për njësi} - 10€$$

$$60€ = \text{Çmimi i shitjes për njësi.}$$

21. Faza ndërkombëtare e zhvillimit ndërkombëtar përfshin:

a) Krijimi i degëve të marketingut dhe prodhimit në të gjithë botën.

b) Formimi i divizioneve ndërkombëtare dhe rritja e mbështetjes nga eksporti.

c) Operim i brendshëm i theksueshëm me një sasi të kufizuar eksporti.

d) Operim i brendshëm i theksueshëm me një sasi të kufizuar importi.

22. Neto Produkti kombëtar (NNP) është i barabartë me Bruto produktin kombëtar (GNP):

a) Minus amortizimi

b) Minus shpenzimet kapitale

c) Plus kapitali

d) Plus puna

23. Kur fitimi margjinal është i barabartë me zero:

a) Firma mund të rrisë fitimet duke rritur prodhimin.

b) Firma mund të rrisë fitimet duke ulur prodhimin.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

- c) Të ardhurat marginale janë të barabarta me të ardhurat mesatare.
- d) Fitimi është maksimal.**

24. Gjatë kryerjes së një auditimi rutinë, një auditor gjeti simptomat e mëposhtme të një ambienti jofunksional të punës: nivele të larta mungesash dhe qarkullimi; respektimi i rreptë i politikave dhe procedurave pa kuptuar qëllimin e tyre; dhe punonjësit që mendonin se trajtoheshin si numra, jo si njerëzit. Këto probleme ka të ngjarë të ndodhin në një organizatë që praktikon:

- a) Menaxhim shkencor.
- b) Burokracia klasike.**
- c) Menaxhimi i Teorisë Y.
- d) Qasja e kontigjencës në menaxhim.

25. Centralizimi dhe decentralizimi përcaktohen në bazë të delegacionit relativ të autoritetit vendimmarrës nga menaxhmenti i lartë. Shumë menaxherë besojnë se organizatat e decentralizuara kanë avantazhe të konsiderueshme në krahasim me organizatat e centralizuara. Një avantazh kryesor i një organizate të decentralizuar është se:

- a) Organizatat e decentralizuara janë më të lehta për tu kontrolluar.
- b) Strukturat e decentralizuara drejtojnë organizatat dhe eliminojnë dyfishimin e burimeve.
- c) Organizatat e decentralizuara kanë më pak menaxherë sesa organizatat e centralizuara.
- d) Organizatat e decentralizuara inkurajojnë iniciativën në rritje midis punonjësve.**

26. Një strukturë organizimi matricë do të ishte më e përshtatshme për cilën nga situatat e mëposhtme të biznesit?

- a) Një prodhues që prodhon një produkt të vetëm për vetëm disa klientë.
- b) Një dyqan ushqimor që operon një zinxhir dyqanesh në të gjithë vendin.
- c) Një shitës automobilistik.
- d) Një kompani ndërtimi me disa projekte të mëdha.**

27. Kur dy organizata kanë procese të ngjashme menaxhimi, kulturë, sisteme dhe struktura, quhet një:

- a) Përshtatje strategjike.
- b) Përshtatje organizative.**
- c) Lidhshmëri e prekshme.
- d) Lidhshmëria e paprekshme.

28. Karakteristika unike e shërbimit që merret posaçërisht me pamundësinë për të ruajtur inventarin e shërbimeve është:

- a) Paprekshmërisë.
- b) Heterogjeniteti.
- c) Prishja.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

d) Pandashmëria.

29. Cila nga fjalitë e mëposhtme në lidhje me qarqet e cilësisë është JO E SAKTË?

- a) Një qark cilësor zakonisht është i përbërë nga një grup prej tetë deri në 10 vartësve dhe mbikëqyrësve.
- b) Një pjesë e konceptit të qarkut të cilësisë përfshin aftësimin e komunikimit të pjesëmarrësve, strategjitë e cilësisë dhe teknikat e analizës së problemeve.
- c) Qarqet e cilësisë takohen në ambientet e kompanisë dhe në kohën e kompanisë.
- d) Qarku i cilësisë ka kontrollin përfundimtar mbi zbatimin e zgjidhjeve të rekomanduara.**

30. Një kompani vendosi të shesë një linjë të biznesit të saj. Pasuritë u shitën për €100,000 dhe kishin një vlerë neto në libra prej €70,000. Norma e tatimit në fuqi ishte 20%. Rezultati i këtij transaksioni do të shfaqet në:

- a) Pasqyrën e Pozitës Financiare si rregullim i periudhës paraprake.
- b) Pasqyrën e të ardhurave si një zë i jashtëzakonshëm.
- c) Pasqyrën e të ardhurave si operacione të ndërprera.**
- d) Pasqyrën e të ardhurave si një ndryshim i kontabilitetit.

31. Nëse qeveria do të rriste normat e tatimit të korporatave, atëherë marrëdhënia fitim pas tatimit - kosto - vëllim për firmat individuale do të ndryshonte si në vijim:

- a) Rentabiliteti do të rritej
- b) Rentabiliteti do të zvogëlohej
- c) Nuk do të ketë ndonjë ndryshim në rentabilitet**
- d) Nuk do të ketë ndonjë ndryshim në marrëdhënien fitim pas tatimit - kosto - vëllim

32. Cila nga sa vijon përshkruan më së miri një kompani transnacionale?

- a) Autoriteti i centralizuar dhe identiteti i veçantë kombëtar.
- b) Autoriteti i decentralizuar dhe identiteti i veçantë kombëtar.
- c) Autoriteti i decentralizuar dhe asnjë identitet i veçantë kombëtar.**
- d) Autoriteti i centralizuar dhe asnjë identitet i veçantë kombëtar.

33. Cila nga sa vijon NUK kërkohet në përgjithësi për të pasur një kontratë të vlefshme?

- a) Aprovim i ndërsjellët.
- b) Qëllim i ligjshëm.
- c) Marrëveshje e drejtë, pa anësi**
- d) Palët që kanë aftësi kontraktuese.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

34. Informacioni i mëposhtëm është pjesë e një bilanci të pa rregulluar të një kompani që jap pajisje me qira më 31 dhjetor 2019:

Paraja në gatshme	€ 17,400
Sigurimi i parapaguar	€ 3,600
Pasuritë jo-qarkulluese	€ 180,000
Zhvlerësimi i akumuluar	€ 32,000
Të pagueshmet tregtare	€ 12,000
Aksionet e zakonshme	€ 60,000
Fitimet e mbajtura	€ 38,000
Gjithsej të hyrat	€ 171,000
Shpenzimet e pagave	€ 80,000
Shpenzimet administrative	€ 14,000

Më 1 tetor 2019, kompania pagoi €18,000 për të rinovuar politikën e vetme të sigurimit për një periudhë tre vjeçare që fillon në atë datë. Ky transaksion nuk është regjistruar. Pagat prej €1,700 janë kryer por nuk janë paguar më 31 Dhjetor 2019. Në 31 Dhjetor 2019, gjendja në deklaratën bankare ishte €12,000. Çeçet e pa paguara arritën në €6,900. Interesi prej €40 ishte kredituar në llogarinë e kompanisë nga banka gjatë dhjetorit, por ende nuk është regjistruar në librat e kompanisë.

Cilat shuma duhet të raportojë kompania për sigurimin e parapaguar dhe shpenzimet e sigurimit në pasqyrat vjetore financiare të përgatitura më 31 Dhjetor 2019?

- a) Sigurimi i parapaguar € 16,500 - Shpenzimet e sigurimit € 1,500
- b) Sigurimi i parapaguar € 16,500 - Shpenzimet e sigurimit € 5,100**
- c) Sigurimi i parapaguar € 18,000 - Shpenzimet e sigurimit € 3,600
- d) Sigurimi i parapaguar € 20,100 - Shpenzimet e sigurimit € 1,500

Llogaritje:

€ 18,000 / 36 muaj = € 500 në muaj

36 muaj - 3 muaj (tetor, nëntor dhe dhjetor 2012) = 33 muaj

€ 500 × 33 muaj = € 16,500 sigurimi i parapaguar në 31 Dhjetor 2019

Saldo fillestare e parapagimit € 3,600

+ Pagesat më 1.10.2019 €18,000

= Gjithsej € 21,600

- Saldo e sigurimit të parapaguar € 16,500

= Shpenzimi i sigurimit € 5,100

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

35. Më 1 dhjetor 2019, një kompani shiti shërbime tek një klient dhe pranoi një letër me vlerë në këmbim me një vlerë nominale €120,000 dhe një normë interesi prej 10%. Letër me vlerë kërkon që principali dhe interesi të paguhet në datën e maturimit, 1 Dhjetor 2020. Periudha kontabël e kompanisë është viti kalendarik. Çfarë hyrje rregulluese (lidhur me këtë shënim) do të kërkohej më 31 Dhjetor 2019, në librat e ndërmarrjes?
- a) Të ardhurat e shtyra nga interesi €1,000 – Të arkëtueshmet €1,000
 - b) Të ardhurat nga interesi €1,000 – Të arkëtueshmet €1,000
 - c) Të arkëtueshmet €1,000 - Të hyrat e shtyra €1,000
 - d) Të arkëtueshmet €1,000 – Të ardhurat nga interesi €1,000**
36. Cila nga deklaratat e mëposhtme është e gabuar në lidhje me shpalosjen e llogarive të arkëtueshme?
- a) Llogaritë e vlerësimit mund të zbriten nga llogaritë e arkëtueshme për humbjet e mundshme që ekzistojnë në të arkëtueshmet.
 - b) Llogaritë e vlerësimit mund të zbriten nga llogaritë e arkëtueshme për zbritjet e vlerësuar dhe kthimet që do të jepen në të ardhmen për llogaritë ekzistuese të arkëtueshme.
 - c) Llogaritë e arkëtueshme duhet të raportohen dhe identifikohen në bilancin e gjendjes si të arkëtueshme të lëna peng nëse ato përdoren si siguri për një hua, e cila tregohet si një pasiv në të njëjtën bilanc.
 - d) Llogaritë e arkëtueshme nga zyrtarët e kompanisë dhe pronarët duhet të klasifikohen si kompensim ndaj ekuitetit të pronarëve.**
37. Qëllimi i një regjistrimi, i cili përmban një debit për parapagimin e tatimit në prone dhe një kredi për shpenzimet e tatimit në pronë, është të njohë një:
- a) Shpenzim të parapaguar**
 - b) Shpenzim të përlllogaritur
 - c) Të ardhura të parapaguar
 - d) Kosto të skaduar
38. Amortizimi i pasurive të pa prekshme gjatë jetës së tyre të dobishme justifikohet nga:
- a) Supozimi i subjektivit ekonomik.
 - b) Supozimi i vijimësisë**
 - c) Supozimi i njësisë monetare.
 - d) Supozimi i kostos historike.

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

39. Çfarë përfundimi duhet të nxjerrë një analist financiar nëse një kompani ka një raport të lartë të qarkullimit të aseteve fikse?
- a) Kompania mund të jetë duke kapitalizuar tej mase.
 - b) Kompania mund të ketë një problem me punëtorët që konvertojnë inventarin në përdorim personal.
 - c) Kompania mund të jetë e nën-kapitalizuar**
 - d) Kompania ka përfitim të favorshëm.
40. Menaxhmenti i Korporatës TapIntuit po analizon pasqyrat financiare të Korporatës Cosmo sepse TapIntuit po konsideron blerjen e disa aksioneve të zakonshme të Cosmo që do t'i jepte TapIntuit ndikim të rëndësishëm mbi Cosmo. Cilën pasqyrë financiare duhet të përdorë kryesisht TapIntuit për të vlerësuar shumat, kohën dhe pasigurinë e flukseve të parave të ardhshme të kompanisë Cosmo?
- a) Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse
 - b) Pasqyrën e fitimeve të mbajtura.
 - c) Pasqyrën e rrjedhjes së parasë së gatshme**
 - d) Pasqyrën e Pozitës Financiare
41. Mos zbatimi siç duhet dhe në kohën e duhur të planit strategjik të biznesit dhe kur qëllimet e menaxherëve dhe qëllimet e personelit jo menaxhues janë jo në përputhshmëri me qëllimet e organizatës paraqet shembull të:
- a) Rrezikut strategjik dhe i biznesit**
 - b) Rrezikut organizativ
 - c) Rrezikut të shkaktuar nga menaxhmenti
 - d) Rrezikut të kapitalit njerëzor
42. Analiza e cila aplikohet për investime dhe tregon se sa do të ndryshojë kthimi në një investim ose vlera e tanishme neto si përgjigje në një ndryshim të caktuar në një variabël të dhënë të pavarur, kur të gjithë faktorët tjerë mbahen konstant paraqet:
- a) Analizën e ndjeshmërisë**
 - b) Analizën e opsionit
 - c) Analizën kosto përfitim
 - d) Analizën e vlerës së prishtshme
43. Cila nga opsionet e më poshtme NUK është lloj i praktikës së mirë për të reduktuar rreziqet e prodhimit dhe procesit?
- a) Caktimi i zyrtarit kryesor të prodhimit.
 - b) Projektimi për sigurinë .
 - c) Dizajnimi për mjedis të gjelbër.
 - d) Kryerja e studimeve për vendosjen e standardeve.**

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

44. Rreziku i kontratës është rezultatet i mos veprimit në përputhje me afatet dhe kushtet e kontratës, duke çuar në dështimin të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale, gjobave dhe dërgesave të vonuara, si dhe shpien në rreziqe financiare dhe ligjore. Cila nga opsionet e mëposhtme është praktikë e mirë për të reduktuar rreziqet e kontratës?

a) Monitorimi i performancës së kontraktorit.

b) Kuptimi i mjediseve globale ekonomike, politike, dhe kulturore.

c) Përputhshmëria me ligjet dhe rregulloret ndërkombëtare të tregtimit si me vendet importuese ashtu edhe me vendet eksportuese.

d) Motivimi dhe edukimi i punonjësve për të zvogëluar tundimit për të përjetësuar mashtrimet dhe për të kultivuar një kulturë të kontrolleve.

45. Nëse një mbikëqyrës përdor një qasje të mbështetëse të menaxhimit, e cila dëshmohet nga ndjenja pozitive dhe shqetësim për vartësit, mund të rezultojë në problem sepse:

a) Një qasje e bazuar në fuqi të pastër e bën të vështirë motivimin e stafit.

b) Kjo qasje varet nga shpërblimet materiale për punëtorin.

c) Kjo qasje varet nga njerëzit që duan të punojnë, të rriten dhe të arrijnë.

d) Menaxheri duhet të besojë në qasjen e punës në ekip.

46. Nga auditimi i një kompanie janë zbuluar katër gabime si më poshtë që kanë ndodhur por nuk janë korrigjuar:

Inventari më 31 Dhjetor 2019 – 40,000€, i nënvlerësuar.

Inventari më 31 dhjetor 2020 - 15,000€, i mbivlerësuar.

Amortizimi për vitin 2019 – 7,000€, i nënvlerësuar.

Shpenzimet e përlogaritura më 31 dhjetor 2020 - 10,000€, të nënvlerësuar.

Gabimet ndikojnë që fitimet e mbajtura të raportuara më 31 dhjetor 2020 të:

a) Mbivlerësohen për 65,000€.

b) Mbivlerësohen për 32,000€.

c) Mbivlerësohen për 25,000€.

d) Nēnvlerēsohen për 18,000€.

47. Pasuritë/asetet e një kompanie që është në proces të likuidimit duhet të regjistrohen në pasqyrën e pozitës financiare në:

a) Koston historike të pa amortizuar.

b) Vlerën e drejtë të tregut.

c) Vlerën neto të realizueshme.

d) Koston aktuale.

48. Një kompani shet një pjesë të makinerive, për para të gatshme, para përfundimit të jetës së dobishme të vlerësuar. Çmimi i shitjes është më i vogël se vlera neto në libra e pasurisë në datën e shitjes. Regjistrimi kontabël që kompania duhet ta bëjë për shitjen është:

Të gjitha pyetjet janë me zgjidhje të shumëfishtë, ku vetëm njëra zgjidhje është e saktë.

Rrumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

Nga 2 pikë secila

- a) Debi: Paraja në dorë
Debi: Zhvlerësimi i akumuluar - makineria
Kredi: Fitimi nga shitja e makinerisë
Kredi: Makineria
- b) Debi: Paraja në dorë
Debi: Humbja nga shitja e makinerisë
Kredi: Zhvlerësimi i akumuluar - makineria
Kredi: Makineria
- c) Debi: Paraja në dorë
Debi: Makineria
Kredi: Zhvlerësimi i akumuluar - makineria
Kredi: Fitimi nga shitja e makinerisë
- d) Debi: Paraja në dorë
Debi: Zhvlerësimi i akumuluar - makineria
Debi: Humbja nga shitja e makinerisë
Kredi: Makineria**

49. Një kompani përdor metodën e amortizimit të shumës së shifrave për vite. Cila pjesë e kostos së amortizueshme të një pasurie katër vjeçar do të shpenzohet në vitin e tretë të përdorimit të aktivit?

- a) 10%
- b) 30%
- c) 33,33%
- d) 20%**

Nën metodën e shumës së shifrave të viteve, pjesa e kostos së amortizueshme që llogaritet si shpenzim në çdo vit të caktuar llogaritet si: numri i viteve të vlerësuara të jetës së mbetur në fillim të vitit pjesëtuar me shumën e viteve të jetës së dobishme të vlerësuar. Prandaj, pjesa në shpenzim në vitin e tretë të një aktivi me një jetë të dobishme të vlerësuar katër vjeçare = $2 / (1 + 2 + 3 + 4) = 2/10 = 20\%$.

50. Cila nga opsionet e mëposhtme i referohet shkallës në të cilën njerëzit pranojnë pabarazinë midis institucioneve, organizatave dhe njerëzve?

- a) Shmangia e pasigurisë.
- b) Individualizmi.
- c) Kolektivizmi.
- d) Distanca e fuqisë.**